




Pasqyra Makroekonomike publikohet nga Ministria e Financave çdo tre muaj dhe ka për qëllim informimin mbi zhvillimet tremujore ekonomike në Kosovë.

Sektori Real


Ekonomia vendore pritet të rritet me rreth 4% përgjatë vitit 2016, rritje kjo e ndikuar kryesisht nga rritja e kreditimit pas rënies së normave të interesit (rreth 30% rënie përgjatë dy viteve të kaluara), rritjes së të hyrave të disponueshme pas rënies së çmimeve në përgjithësi dhe në veçanti atyre në derivate, si dhe intensifikimit të investimeve publike. Kontribut i veçantë në këtë rritje të aktivitetit ekonomik vlerësohet të ketë ardhur nga reformat fiskale si dhe reformat strukturore të ndërmarra përgjatë periudhës paraprake. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave (shih grafikun 1), BPV në tremujorin e dytë të vitit 2016 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka shënuar rritje prej 2.9%.

Grafiku 1. BPV reale, sipas qasjes së shpenzimeve



Sa i përket lëvizjeve të çmimeve, përgjatë periudhës raportuese, indeksi i çmimit të konsumatorit (ICK) ka vazhduar të tregojë stabilitet.

Grafiku 2. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit



Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike pësuan një rënie prej 0.3% në mesatare. Megjithatë, siç mund të shihet nga grafiku 2, IÇK në fund të periudhës raportuese ka filluar të tregojë tendencë ngritëse, kjo si rezultat i fillimit të ngritjes së çmimeve botërore të ushqimit dhe transmetimi i këtyre presioneve inflacionare në vend.


Për më shumë, si tregues gjithashtu i rëndësishëm i zhvillimeve në sektorin real mund të cilësohen numri i bizneseve të reja të regjistruara dhe përceptimet e bizneseve për ambientin e përgjithshëm biznesor. Në këtë drejtim, nga të dhënat e ASK-së (Tabela 1) vërejmë se në Kosovë deri në fund të muajit shtator 2016 u regjistruan gjithsej 2476 biznese të reja, apo 192 biznese të reja të regjistruara më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlen të theksohet se numri i bizneseve të reja të regjistruara janë në sektorin e prodhimit dhe në bujqësi. Gjithashtu, kemi një rënie të bizneseve të reja të regjistruara në tregti. Rrjedhimisht, nga këto të dhëna mund të vlerësojmë se janë duke u materializuar shenjat e para të ndryshimit të strukturës ekonomike të vendit, ku si rezultat i subvencionit të bujqësisë dhe reformave fiskale, prodhimtaria pritet të ketë një rol të rëndësishëm ekonomik.

Tabela 1. Numri i bizneseve të regjistruara

Sektori i regjistrimit të biznesit	TM3 2015	TM3 2016
Tregti me shumicë dhe pakicë	622	552
Prodhim	239	258
Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	208	372
Ndërtimtari	160	194
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	256	232
Të tjera	799	868
Totali	2284	2476

Pasi që pritjet dhe vlerësimet e bizneseve vendore mbi pritjet ekonomike dhe të bërit biznes janë tregues të rëndësishëm për ecurit ekonomike, në vijim janë të paraqitura të dhënat nga Oda Ekonomike e Kosovës të cilat pasqyrojnë pozitën e sektorëve sipas vlerësimeve të bizneseve.

Grafiku 3. Klima e biznesit në TM3 2015



Të dhënat e tremujorit të tretë të vitit 2015 dhe 2016 tregojnë se përshtypjet e shumicës së bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes kanë qenë pozitive. Megjithatë, kjo nuk vlen edhe për sektorin e ndërtimtarisë dhe bizneset e shitjes me shumicë.

Sektori i ndërtimtarisë mund të paraqesë vlerësime të tilla për shkak se fillimi i sezonës së dimrit ka ndikim të tillë tek ky sektor. Ndërkaq, sektori i shitjes me pakicë shohim se ka kaluar nga kuadranti i djathtë-poshtë në atë me klimë pozitive dhe përmirësim.


Grafiku 4. Klima e biznesit në TM3 2016



Grafiku 5. prezanton pritjet e bizneseve mbi klimën që do të mbizotërojë për muajt në vijim. Përshtypjet e bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes ngjasojnë me pritjet mbi klimën që do të mbizotërojë për gjashtë muajt e ardhshëm.

Vlen të theksohet se në përgjithësi pritshmëritë e bizneseve janë pozitive sa i përket klimës që do të mbizotërojë në muajt e ardhshëm.

Grafiku 5. Pritjet e bizneseve në TM3 2016 për gjashtë muajt e ardhshëm



Sektori i Jashtëm

Importi i produkteve vazhdon të ketë trend pozitiv, duke shënuar një rritje të lehtë në raport me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm. Siç mund të shihet nga Tabela 2, deri në fund të TM3 të këtij vit u importuan mallra në vlerë prej mbi 744 milionë euro, apo një rritje prej 3.1% të importit total në krahasim me periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2015.

Tabela 2. Importi sipas produkteve, në '000 euro

Kategoria	TM3 2015	TM3 2016
Ushqim, pije, duhan	102,166	105,546
Produkte minerale	114,798	93,673
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	76,046	74,401
Makineri, pajisje makinerike e elektrike	80,532	94,067
Të tjera	348,583	376,408
Totali	722,125	744,095

Në tabelën 3. paraqiten të dhënat e importit sipas shteteve dhe vërehet se afërsisht 42% e importit total vjen nga shtetet e Bashkimit Evropian. Ndërsa, vendet me pjesëmarrje më të lartë të importit janë Serbia, Gjermania, Kina, Turqia dhe Italia. Sa i përket importit nga Gjermania, ai ka shënuar rritje prej afro 20% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Për më shumë, importi nga Italia sikurse edhe në tremujorin e dytë ka vazhduar të ketë trend negativ.

Tabela 3. Importi sipas shteteve, në '000 euro

Shteti	TM3 2015	TM3 2016
Gjermania	75,451	90,748
Italia	62,899	57,664
Serbia	108,862	106,744
Turqia	66,589	71,445
Kina	62,272	73,463
Të tjera	346,052	344,031
Total	722,125	744,095

Në anën tjetër, përgjatë tremujorit të tretë në vitin 2016 eksporti ka shënuar rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm. Eksporti gjatë kësaj periudhe arrin vlerën e mbi 73.5 milionë euro, që në përqindje shënon rënie prej rreth 17%.

Tabela 4. Eksporti sipas produkteve, në '000 euro

	TM3 2015	TM3 2016
Produktet minerale	14,283	15,985
Metalet bazë dhe artikuj	35,697	22,835
Plastika, goma dhe artikuj	6,455	7,382
Të tjera	32,927	27,329
Total	89,362	73,531

Të dhënat nga tabela 4. paraqesin një rënie të dukshme në eksportin e metaleve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë këtij tremujori kjo kategori përbën rreth 45% të eksportit total. Në këtë tremujor vërehet rritje në eksportin e produkteve të plastikës dhe gomës dhe produkteve minerale. Mbi gjysma e eksporteve kosovare u destinuan në shtetet e CEFTA-s dhe të BE-së.

Tabela 5. Eksporti sipas shteteve, në '000 euro


Shteti	TM3 2015	TM3 2016
Gjermania	3,711	3,658
Italia	2,472	1,368
Bullgaria	523	2,735
Shqipëria	10,850	11,335
Maqedonia	8,475	9,834
Serbia	12,897	10,664
India	9,062	1,589
Të tjera	45,606	38,741
Total	93,596	79,924

Nga tabela 5. shihet rënie në eksport me vendet si Italia, Serbia dhe India. Mirëpo, vërehet rritje e eksportit në Bullgari, ndërkohë që vendet e CEFTA-s edhe më tutje vazhdojnë të mbesin partnerët kryesor për eksportin e mallrave.

Sektori Fiskal


Të hyrat e përgjithshme buxhetore vazhdojnë të shënojnë ngritje të theksuar e treguar përgjatë gjithë vitit, ku deri në fund të periudhës raportuese, të hyrat e përgjithshme buxhetore kanë shënuar një ngritje prej rreth 14% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo ngritje në arkëtim vjen si rezultat i aktivitetit të shtuar ekonomik në vend dhe gjithashtu edhe ngritjes së efijencës së agjencive mbledhëse si rezultat i reformave strukturore të ndërmarra.

Grafiku 6. Të hyrat, në milionë euro




Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, ato shënuan një ngritje prej 5.4% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në përgjithësi, edhe përkundër ekzekutimit të ulët të shpenzimeve kapitale, shpenzimet në këtë kategori kanë shënuar ngritje në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Megjithatë, këto shpenzime pritet të shënojnë ngritje të theksuar në tremujorin e fundit të vitit.

Grafiku 7. Shpenzimet, në milionë euro



Tek grafiku i paraqitur më poshtë janë të paraqitura normat e interesit për letrat me vlerë (LV) Monetare Bono të Thesarit të Kosovës me maturitet 3M, 6M dhe 12M, ku normat e baras-peshuara të interesit kanë shënuar rënie përgjatë viteve. Kjo rënie kryesisht i atribuohet likuiditetit të lartë në sektorin bankar (si investor kryesor në letrat me vlerë) si dhe gjithashtu, besueshmërisë kreditore të Qeverisë së Republikës së Kosovës si rezultat i stabilitetit makro-fiskal. Duke reflektuar në një masë kërkesën për investime në LV.

Grafiku 8. Norma e interesit në Bono të Thesarit të Kosovës, në mesatare




Sektori Financiar

Sektori financiar në Kosovë mbetet mirë i kapitalizuar, likuid dhe profitabil si rezultat i përforsimit të procedurave konservative ndaj riskut kreditor. Bazuar në të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës, depozitat në sektorin bankar shënuan një rritje prej 5% në raport me vitin e periudhën e njëjte me vitin paraprak. Përderisa, kreditë shënuan një ngritje të theksuar prej 10% në krahasim me periudhën e njëjte të vitit 2015. Asetet totale shënuan rritje prej 6%, duke arritur në 3.5 miliardë euro në fund të periudhës raportuese.

Tabela 6. Depozitat dhe kreditë në sektorin financiar, kumulative, fundi i periudhës (në milionë euro).

	TM3 2015	TM3 2016
Depozitat	2,656	2,789
Kreditë	1,993	2,184
Asetet Totale	3,321	3,513

Grafiku 9. Raporti mes kredive dhe depozitave



Kjo ngritje e theksuar në kreditim të sektorit privat vjen si rezultat i rritjes së kreditimit të sektorit të Bujqësisë dhe Shërbimeve në përgjithësi. Megjithatë, vlera e kredive për këto dy kategori mbetet e ulët në krahasim me kreditë që janë marrë në sektorin e Industrisë dhe Energjisë. Sipas tabelës 7, vërejmë se kreditë në këta dy sektorë kapin shifrën e 906 milionë eurove.

Tabela 7. Kreditë e korporatave tjera depozituese, kumulative, fundi i periudhës (në milionë euro)

	TM3 2015	TM3 2016
Bujqësia	54	59
Industria dhe energjetika	211	213
Ndërtimtaria	98	102
Tregtia me shumicë dhe pakicë	694	693
Shërbimet fin., patundshmëri, qira, etj.	89	101
Shërbimet tjera	179	213
Total	1,325	1,381

Në shtator të vitit 2016 raporti kredi/depozita ishte 78.9% duke shënuar rritje prej 3.5 pika të përqindjes në mesatare, ku kërkesa për kreditim vazhdon të rritet si rezultat i rënies së normave të interesit. Duke reflektuar likuiditetin bankar, normat e interesit në kredi shënuan rënie mesatare nga 10.6% (2014) në 8.32% (2015), dhe 7.54% në shtator (2016).

Tabelë përmbledhëse

Përshkrimi	TM3 2015			TM3 2016		
	Korrik	Gusht	Shtator	Korrik	Gusht	Shtator
<i>në milionë euro, për muaj, përveç ku ceket ndryshe</i>						
Sektori Real						
Bruto Produkti Vendor	:	:	1,610	:	:	:*
IÇK (ndryshimi në %, mujore)	-0.8	-0.7	-1.2	0.0	0.0	0.6
Sektori i Jashtëm						
Importi i mallrave	246	245	231	241	270	233
Eksporti i mallrave	37	28	24	30	21	22
Bilanci tregtar	-209	-217	-206	-211	-249	-211
Sektori Fiskal						
Të hyrat e përgjithshme <i>prej të cilave:</i>	148	124	121	159	159	144
Të hyrat nga tatimet direkte	27	10	9	31	16	17
Të hyrat nga tatimet indirekte	107	108	105	109	133	118
Shpenzimet e përgjithshme <i>prej të cilave:</i>	127	122	132	108	144	142
Shpenzimet rrjedhëse	89	90	94	92	103	90
Shpenzimet kapitale	36	29	32	16	39	47
Sektori Financiar (kumulative, fundi i periudhës)						
Depozitat	2,615	2,656	2,657	2,720	2,797	2,789
Kreditë	2,001	1,985	1,993	2,184	2,168	2,184
Asetet totale të sektorit financiar	3,296	3,349	3,321	3,451	3,519	3,513

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës
Banka Qendrore e Kosovës
Thesari i Kosovës (Ministria e Financave)
Oda Ekonomike e Kosovës

(:) – nuk ka të dhëna: në këto raste, të dhënat janë të disponueshme vetëm për tremujorin si tërësi
* të dhënat nuk janë të gatshme në kohën e publikimit të kësaj Pasqyre

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Pasqyra publikohet çdo tremujor dhe çdo përmirësim bëhet në faqen zyrtare në internet. Për çdo dallim mes versioneve, mbizotëron ai në gjuhën shqipe.

Departamenti për Politika Ekonomike dhe Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar
Njësia e Makroekonomisë
Nëntor 2016